

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I. D., nga Shtimja, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a. në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson H. I., për shkak të anulimit të aktvendimit dhe kompensimit të diferencës së pagës, përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1382/2017 datë 26.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 16.3.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1382/2017 datë 26.12.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1382/2017 datë 26.12.2017, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, C. nr. 2596/13 datë 30.11.2016, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është miratuar në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit I. D., nga Shtimja dhe është anuluar si i kundërligjshëm aktvendimi i të paditurës nr..., datë ..., Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura PTK sh.a. me seli në Prishtinë, që në afatin kohor prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit paditësit në emër të ndryshimit - diferencës në pagë në mes të gradës 8 dhe 7, për periudhën kohore prej 1.2.2012 deri më 20.7.2016 të paguaj shumën neto të parave prej 5.294,16 €; kamatën në shumë prej 832,67 € dhe kontributin pensional në Trustin Pensional, në emër të paditësit në shumën prej 280,80 €, ndërsa nga data 1.8.2016 e deri në ekzistimin e kushteve ligjore paditësin për punën e tij ta shpërblejë me pagë mujore në lartësi të gradës 8. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar e paditura që në afatin kohor prej 15 ditësh të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 170 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit

të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni dhe dy aktgjykimet e lartcekura të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës , në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion , dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura në kohë të pacaktuar në vendin e punës kryeteknik, duke filluar nga data 1.6.2011, e tutje, për të cilin vend pune me këtë kontratë është paraparë paga sipas gradës 8. E paditura me vendimin nr. ..., datë ..., paditësit i zbret gradën e punës nga 8 në 7. Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë, mirëpo lidhur me ankesën e tij e paditura fare nuk ka vendos, kështu që paditësi më datën 9.10.2013, i është drejtuar me padi gjykatës, me kërkesë që të anulohet aktvendimi nr. ...,datë ..., dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë diferencën kontestuese të pagës në tërësi sipas kontratës së punës.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj anuloi vendimin kontestues dhe detyroi të paditurën që paditësit t'i paguajë diferencën e pagës sipas gradës 8, më afër si në dispozitiv të aktgjyimit të saj, pasi që gjeti se e paditura me zvogëlimin e gradës së paditësit prej 8 në 7, në mënyrën e përshkruar më lartë, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e punës, pa marrë pëlqimin e paditësit për ndërrimin e kushteve të kontratës.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e ankimuar e ka vërtetuar, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 55 të Ligjit të Punës kur ka vendosur si në pjesën I të dispozitivit, ndërsa edhe lidhur me pjesën II dhe III të dispozitivit të aktgjyimit, në tërësi ka aprovuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se pretendimet e cekura në ankesë janë të pabazuara. Për më tepër gjykata e shkallës së dytë gjen se ndërrimi i gradës në kundërshtim me kontratën e punës dhe pa pëlqimin e punonjësit si palë kontraktuese nuk mund të bëhet një anshëm me një vendim të drejtorit menaxhues.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të parë, lidhur me aprovimin si të bazuar të

kërkesëpadisë së paditësit sa i përket anulimit si të kundërligjshëm të vendimit kontestues të paditurës, obligimit të paditurës që paditësit t'i paguaj shumën prej 5.294,16 €, kamatën në shumë prej 832,67 €, kontributin pensional në shumë prej 280,80 € dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e lartcekura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika (n) LPK, të cilat pretendime u refuzuan si të pabazuara, nga se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, nuk përmbajnë të meta e paqartësi, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit.

U refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet tjera të revizionit për shkelje thelbësore procedurale nga neni 182.1 lidhur me nenin 190 e 191 të LPK, të cilat sipas të paditurës qëndrojnë në atë se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së të paditurës nuk ka mbajtur seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes në të cilën është dashur të thirren edhe palët. Këto pretendime të revizionit janë të pabazuara, për faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë, kështu që duke vlerësuar edhe se në procedurë ankimore nuk janë paraqitur fakte dhe prova të reja , edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka pas për obligim të mbajë seancë gjyqësore në prezencën e palëve lidhur me ankesën e të paditurës.

Qëndron fakti se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka përmes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin edhe pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Sipas të paditurës kërkesëpadia me të cilën paditësi ka kërkuar pagesën e diferencës kontestuese të pagës është

vjetërsuar. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitje të padisë nga se kontesti ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të paditurës për zvogëlimin e pagës, e për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës afati i parashkrimit është 3 vite, e jo siç pretendohet në revizion se afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i punësuari në pajtim me nenin 55 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Punës ka të drejtë në pagë e cila i caktohet me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit, sipas kontratës së punës, në pajtim me nenin 11.1.8 të Ligjit të punës ka qenë sipas gradës 8, prandaj ulja e pagës nën këtë gradë pa pëlqimin e paditësit është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës, dhe me dispozitat e lartë përmendura ligjore. Kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomike, lidhur me shpenzimet e uljeve operative të e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative , e as që thuhet në atë rekomandim për uljen e pagave, dhe se e paditura është dashur të paraqet një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, andaj thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me zvogëlimin e gradave, dhe se nuk mund të bëhet kjo me një vendim të njëanshëm të kryeshefit Ekzekutiv të paditurës.

Mirëpo, sa i përket periudhës për të cilën është aprovuar pagesa e diferencës së pagës, kamatës dhe kontributit pensional Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimet e lartpërmendura nuk përfshihen me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kjo ngase qëndron fakti se me kontratën tjetër të punës të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës nr. ..., datë ..., paditësit në të njëjtin vend pune i është caktuar grada në lartësi prej 7 e jo 8 sikur me kontratën e parë të punës, dhe se paditësit diferenca e pagës kishte për t'i takuar ligjërisht vetëm deri në ditën kur me të paditurën ka nënshkruar këtë kontratë tjetër të punës, mirëpo e paditura me fajin e vet nuk e ka prezantuar këtë kontratë asnjëherë gjatë zhvillimit të procedurës në këtë çështje juridike, e as që është thirr në të, edhe pse për të njëjtën ka qenë në dijeni shumë kohë para përfundimit të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe ka pasur mundësi që të njëjtën ta propozojë si provë, kështu që kjo kontratë nuk ka pas mundësi që nga gjykata të administrohet si provë me fajin e të paditurës, ndërsa paraqitjen e kësaj prove me revizion Gjykata Supreme nuk

e mori parasysh, nga se në kuptim të nenit 216 të LPK palët mund të parashetrojnë me revizion fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë, dhe pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti paraqesin më herët.

Gjykata Supreme e Kosovës vërejti se me ankesën e paraqitur para Gjykatës së Apelit e paditura ka prezantuar kontratën e punës nr. ..., datë ..., me pretendimin se palët janë pajtuar për kushtet e kontratës, por në kuptim të nenit 180 par.1 të LPK –ës as me ankesë palët nuk mund të paraqesin fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, andaj, një rrethanë e tillë nuk ndikojë që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe.

Lidhur me aprovimin e lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit gjykata ka vendosur në bazë të ekspertizës së ekspertit financiar, të cilën ekspertizë nuk e ka kundërshtuar pala prezentë në shqyrtimin kryesor.

Për arsyet e paraqitura më lart, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.42/2018 datë 16.3.2018

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku